




REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA	
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo	
Ministria e Zhvillimit Ekonomik / Ministarstvo Ekonomskog Razvoja	
Ministry of Economic Development	
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	01
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	1239
Nr. i fozave Broj stranica No. pages:	1
Data Datum Date:	28.05.19
PRISHTINË/A	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja / Ministry of Economic Development

Nga: Valdrin Lluka
Ministër
Ministria e Zhvillimit Ekonomik

Për: Z. Arsim Janova
U.D. i kryesuesit të Bordit
Zyra e Rregullatorit t' Energjisë

Prishtinë më, 27 Maj 2019



Tema: Raporti konsultativ për mekanizmin e mbështetjes për caqet e BRE-ve (20 MW Solare Fotovoltaikë)

Inderuar z. Janova

Sic e dini, pos priorititetit kryesor të Qeverisë për siguri të furnizimit me energji elektrike, diversifikimi i burimeve të gjenerimit dhe tranzicioni gradual në burime te ripërtitshme të energjisë, është po ashtu një nga prioritetejet e rëndësishme të Qeverisë së Kosovës. Në të njëjtën kohë, ky i fundit është edhe obligim kontraktual në raport me komunitetin e energjisë.

Në krejt këtë proces transformues të sektorit, besoj se shqetësimi i të dy institucioneve tona mbetet në rend të parë reflektimi në tarifat finale të konsumatorit, e cila prek drejtpërdrejt mirëqenien e qytetarëve tonë.

Mbi këtë bazë si dhe referuar raportit konsultativ për "Mekanizmin e Mbështetjes për caqet e BRE-ve (20 MW Solare Fotovoltaikë)" të vendosur në diskutim publik nga zyra e rregulatorit, ne si ministri konsiderojmë se, përkundër specifikave të vendit të cilat natyrshëm bëjnë diferençën në koston e projekteve të tillë, tarifa e propozuar është shumë e lartë dhe jashtë trendëve të çmimeve të arritura në region si dhe kostos në rënje të këtyre teknologjive.

Të shqetësuar thellësisht se kjo tarifë do të ketë impakt të ndjeshëm në tarifat e konsumit final, kërkojmë që të rishqyrtoni rrënjosht supozimet që keni përdorur për të arritur te drafti i propozuar në mënyrë që të kemi një çmim shumë më të ulët, i cili reflekton qasjen balancuese në zhvillimin këtyre projekteve duke vendosur theks të veçantë në mirëqenien sociale të qytetarëve të vendit.

Për më tepër, modeli i tarifave nxitëse të përcaktuara në mënyrë administrative është një nga format të cilat nuk është duke u përdorur në asnjë nga vendet e regionit. Prandaj, rekomandoj që bashkërisht të gjejmë modalitetet që në të ardhmen, çmimi për këto projekte të jetë derivat i procedurave përmes skemave konkurruese të tregut.

Së fundmi ky rekomandim për Kosovën, ka dalë edhe në deklaratën e përbashkët të Ministrave të Financave të vendeve të Bashkimit Evropian si dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor në kuadër të programit për Reforma Ekonomike(ERA 2019-21), në takimin e mbajtur më 17 Maj 2019 në Bruksel.

Me respekt,
Valdrin Lluka
Ministër